



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:121073
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05759241

PAKR.nr.151/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Kadrije Goga Lubishtani - kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Afërdita Bytyçi – anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarve, A.Th., për shkak të veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, B.M. për shkak të veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së dhe L.K. për shkak të veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.10/2022 të datës 20.02.2024, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës PKR.nr.45/2022 të datës 24.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.10/2022 të datës 20.02.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës PKR.nr.45/2022 të datës 24.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.45/2022 të datës 24.01.2024, të akuzuarit A.Th., B.M. dhe L.K., konform neni 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, i ka liruar nga aktakuza pasi që nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Nga të akuzuarit janë konfiskuar monedhat e falsifikuara dhe atë nga: A.Th. 284 monedha në vlerë prej 2 euro të falsifikuara, nga B.M. 63 monedha në vlerë prej 2 euro të falsifikuara dhe nga L.K. 50 monedha në vlerë prej 2 euro të falsifikuara, të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit të ankimuar duhet të shkatërrohen.

Monedhat tjera të cilat nuk kanë rezultuar të falsifikuara duhet të iu kthehen të akuzuarve dhe atë të akuzuarit A.Th. t'i kthehen 149 monedha metalike në vlerë prej 2 euro, të akuzuarit B.M. 6 monedha metalike në vlerë prej 2 eurove dhe të akuzuarit L.K. 69 monedha metalike në vlerë prej 2 eurove, të njëjtat të kthehen pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit të ankimuar.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit A.Th. av. B.B. me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës në tërësi të hudh ankesën si të pabazë dhe të vërtetoj aktgjykimin e ankimuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit L.K. av. K.K. me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të refuzoj ankesën e Prokurorisë si të pabazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.150/2024, datë 13.03.2024 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda të aprovohet ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet te gjykata e shkallës së parë për rigjykim dhe vendosje, ndërsa përgjigjet në ankesë nga mbrojtësit e të akuzuarve A.Th., av. B.B. dhe L.K., av. K.K., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën kanë prezantuar të akuzuarit A.Th., B.M. dhe L.K., ndërsa palët tjera edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës, nuk kanë prezantuar në seancë, gjë që konstatohet nga fletëkthesa, si në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit gjyqësor dhe shqyrtoj shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se: **Ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokuroria Themelore në Prizren pretendon se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par. 1 nën paragrafi 1.10 lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPP-ës për shkak se gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë në arsyetimin e aktgjykimit se në cilat fakte dhe prova është bazuar me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues ndaj të akuzuarve. Veçanërisht sipas prokurorisë, në shqyrtimin kryesor gjykata nuk ka arsyetuar besueshmërinë e fakteve dhe provave me rastin e vërtetimit të mos ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale në veprimet e të akuzuarve. Sipas ankesës, gjykata në arsyetim nuk ka vërtetuar dashjen si element qenësor të veprës penale në veprimet e të akuzuarve, ani pse të njëjtit kanë deklaruar se kanë pranuar para me qese - monedha metalike nga 2 € nga palët të cilët kanë blerë artikuj të ndryshëm. Sipas prokurorisë, të akuzuarit në bizneset e tyre është dashur të jenë të pajisur me pajisje të cilat e bëjnë të mundur detektimin e monedhave false. Po ashtu, prokuroria pretendon se gjykata nuk ka dhënë arsyetime të

mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare duke mos e arsyetuar mjaftueshëm elementin e dashjes gjatë marrjes së aktgjykimit lirues. Sa i përket fakteve vendimtare, prokuroria thekson se gjykata nuk i ka dhënë besueshmëri fakteve notore dhe provave siç është raporti i ekzaminimit laboratorik, i cili ka konstatuar se monedhat metalike nga 2 € tek bizneset e të akuzuarve janë të falsifikuara në tërësi dhe në sasi si në dispozitivin e aktakuzës. Tutje shton se nga vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë duke marrë aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve ka bërë shkeljen e ligjit penal në favor të akuzuarve. Prokuroria pretendon se gjykata ka nxjerr përfundime të gabuara me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues duke mos dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse se në cilat prova e ka mbështetur aktgjykimin lirues ndaj të akuzuarve A.Th., B.M., L.K., të cilët i ka liruar nga akuza.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë dhe as që ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prizren se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, e në përputhshmëri të plotë me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu, konform dispozitës të nenit 369 par.10 e lidhur me nenin 363 të KPPK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë, meqenëse me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është provuar se të akuzuarit se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar nga PTH-në Prizren.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të paraqitura nga Prokuroria Themelore në Prizren, Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se, gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se të akuzuarit A.Th., B.M. dhe L.K. kanë kryer secili veç e veç veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, me ç ‘rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë duke marrë aktgjykim me të cilin të akuzuarit i ka liruar nga akuza, pasi që nga provat e administruara rezulton se në veprimet e të akuzuarve nuk përmbushen elementet e veprës penale gjegjësisht elementi subjektiv-dashja direkte, e veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Kolegj penal i kësaj Gjykate, në këtë çështje penale vlerëson si të drejta përfundimet e shkallës së parë, e që deri tek kjo gjendje faktike gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe materiale si, Raportin e ekspertimit AKF/1021 – 1649/2021 – 1517 të datës 07.09.2021 së bashku me foto dokumentacionin, shikimi në foto dokumentacionin nga vendi i ngjarjes të subjekteve “B. & A.” SHPK, NTP “B.”, dhe subjekti L.K. te tregu “F.”, në P., leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër te rastit 2021-KE-113 e datës 11.06.2021 të A.Th. 433 monedha metalike me nga 2 euro, te B.M. 69 monedha metalike me nga 2 euro, dhe te L.K. 119 monedha metalike me nga 2 euro.

Nga raporti i ekspertimit AKF/1021 – 1649/2021 – 1517 të datës 07.09.2021 se bashku me foto dokumentacionin gjykata ka vërtetuar se monedhat e konfiskuara kanë rezultuar të falsifikuara dhe atë tek A.Th. 284 monedha metalike me nga 2 euro, te B.M. 63 monedha metalike me nga 2 euro, dhe te L.K. 50 monedha metalike me nga 2 euro. Pra, nuk është kontestuese fakti se monedhat janë të falsifikuara, por me këtë dëshmi nuk është vërtetuar asnjë veprim inkriminues për të akuzuarit se a kanë qenë në dijeni se këto monedha janë të falsifikuara.

Nga shikimi në foto dokumentacionin nga vendi i ngjarjes të subjekteve “B.& A.” SHPK, NTP “B.”, dhe subjekti L.K. te tregu “F.”, në P., është vërtetuar fakti se këto monedha janë gjetur konfiskuar tek arkat e bizneseve të tyre. Pra, nuk është kontestuese fakti se monedhat janë gjetur tek bizneset e tyre, por me këtë dëshmi nuk është vërtetuar asnjë veprim inkriminues për të akuzuarit se a kanë qenë në dijeni se këto monedha janë të falsifikuara.

Nga leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit 2021-KE-113 e datës 11.06.2021 të A.Th. 433 monedha metalike me nga 2 euro, te B.M. 69 monedha metalike me nga 2 euro, dhe te L.K.119 monedha metalike me nga 2 euro. Pra, nuk është kontestuese fakti se monedhat janë gjetur tek bizneset e tyre, por me këtë dëshmi nuk është vërtetuar asnjë veprim inkriminues për të akuzuarit se a kanë qenë në dijeni se këto monedha janë të falsifikuara.

I akuzuari A.Th. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se lidhur me monedhat metalike nga 2 euro që janë konfiskuar me dt. 11.06.2021 në subjektin e tij, “B.” te tregu “F.”, këto monedha metalike i kanë ardhur nga të gjitha tregje të komunës së P. pasi punon me klient nga të gjitha viset e Kosovës duke shtuar se ka raste kur subjektet të ndryshëm artikujt i kanë paguar me monedha të këtilla nga 2 euro madje edhe ato i kanë sjell edhe me kese të najlonit dhe se ato i ka pranuar pa dije parapake se janë të falsifikuara pasi nuk posedon aparaturë për identifikimin e tyre dhe nuk i njeh monedhat metalike nga 2 euro dhe 1 euro që mund të jenë të falsifikuara nga ato të vërteta. Më tutje ka deklaruar se ka pasur raste kur kanë ardhur persona për të paguar mallin dhe paratë i ka pasur të pështjellur me lepak me të cilat e ka paguar mallin e blerë. Se paratë kanë qenë të falsifikuara e ka kuptuar kur i është ngritur aktakuza dhe se aty e ka parë se i kanë dalur 284 monedha të falsifikuara me nga 2 euro. Pas ndodhjes së rastit nuk ka pranuar më monedha me nga 2 euro gjë që e ka pasur të shënuar në letër e të cilën më pas i është dashur ta heq për shkak të inspeksionit.

I akuzuari B.M. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se gjatë bastisjes që është kryer në subjektin e tij ekonomik, “B.” te tregu “F.” monedhat që kanë rezultuar të falsifikuara prej 2 euro gjithsej 63 në shumë prej 126 eurove ka marr nga myshteritë – blerësit që ka pasur me rastin e shitjes së artikujve dhe nuk ka pasur njohuri se këto monedha metalike janë të falsifikuara dhe nuk dinë pse janë në atë sasi të madhe dhe shton se po të kishte ditur vet kishte me i asgjësu apo me i largu nga qarkullimi i biznesit dhe se ato para nuk ka marrë nga një njeri por nga blerësit e ndryshëm të cilët kanë frekuentuar vendin ku ai shet artikuj të ndryshëm pemë dhe perime dhe deri në momentin kur është bërë bastisja i njëjti nuk ka ditur fare se ato monedha metalike mund të jenë të falsifikuara dhe konsideron se shumë është vështirë të identifikohet falsifikimi nga ana e ndonjë eksperti jo ma nga shitësit e zakonshëm. I akuzuari më tutje ka deklaruar se është shitës me shumicë dhe pakicë dhe që te tregu “F.” punon që nga vitit 2001 dhe nuk ka ndonjë aparat që i verifikon monedhat metalike se a janë të falsifikuara. Gjatë periudhës së shkëmbimit tregtar

nuk i ka ndodhur që dikush të cilit i ka kthyer kusur ti ketë thënë ose ti jetë ankuar se ato janë të falsifikuara.

I akuzuari L.K. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se gjatë bastisjes që është kryer me dt. 11.06.2021, në ora 10:30 në subjektin e tij ekonomik NT “L. Komerc” te tregu, “F.” në P., me ç ‘rast janë konstatuar se 50 monedha metalike nga 2 euro në shumë prej 100 eurove se janë të falsifikuara nuk ka njohuri nga i ka pranuar ato por është i bindur se monedhat metalike i marrin nga blerësit e rregullt klientët të cilët furnizohen me pemë dhe perime dhe në shumicën e rasteve pagesat i bëjnë me monedha metalike dhe bankënotë letër, aparaturën për konstatimin e monedhave metalike se a janë të falsifikuara me rastin e pranimit nuk e posedon kështu që pa dije këto monedha i ka pranuar nga blerësit çdo herë duke konsideruar se ato janë origjinal, veten e konsideron të dëmtuar nga mashtrimet që i kanë bërë blerësit e artikujve të ndryshëm tek ai duke i ofruar monedha metalike të falsifikuara. Veprimtarinë e ka në fushën e pemëve dhe perimeve me shumicë dhe pakicë e që këtë veprimtari e ushtron qe 21 vite. Më tutje ka deklaruar se në ditën e bastisjes paratë i ka pasur të vendosur në arkë të qarkullimit ditor ose të shitjes dhe se përveç këtyre monedhave të falsifikuara ka pasur edhe monedha tjera si zakonisht. Monedhat metalike prej 2 euro prej rastit të ndodhur pranon vetëm kur është i sigurt dhe atë në vlera të vogla.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e veta, duke përshkruar në mënyrë të qartë dhe të drejtë se përmes provave të administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit duke e ditur se paratë janë të falsifikuara, pranojnë me qëllim të vënies në qarkullim si të vërteta dhe atë i akuzuari A.Th. 284 monedha metalike nga 2 euro, B.M. 63 monedha metalike nga 2 euro dhe L.K.50 monedha metalike nga 2 euro, në bizneset e tyre të cilat operojnë tek tregu “F.” në P., të cilët ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së pemëve dhe perimeve me shumicë dhe pakicë, ashtu që nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk ka mund të vërtetohet elementi qenësor-subjektiv i kësaj vepre penale “**dashja direkte**” për të kryer këtë vepër penale, e po ashtu nuk është vërtetuar asnjë fakt apo rrethanë se të njëjtit kanë qenë në dijeni se posedojnë para të falsifikuara.

Një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar e mbështet edhe ky kolegji penal i kësaj gjykate si të drejtë dhe të ligjshëm ngase nga provat si në shkresat e lëndës nuk rezulton të jetë provuar dijenia e të akuzuarve se paratë janë të falsifikuara dhe që i

kishin pranuar me qëllim të vënies në qarkullim si të vërteta, pasi që këto si elementet (subjektive) të veprës penale, në kuptim të nenit 22 të KPK-së, nuk kanë mund të nxirren nga rrethanat faktike me provat në të cilat prokuroria ka mbështetur aktakuzën për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarve për veprën penal për të cilën i ka akuzuar të akuzuarit me aktakuzë.

Përkitazi me pretendimin e shkeljes së ligjit penal, kolegji penal i kësaj gjykate gjen si të pabazuar për faktin se duke qenë se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjendjen e fakteve ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rezulton se në këtë rast nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e në këtë drejtim nuk ka as zbatim të ligjit penal e rrjedhimisht as në favor e të akuzuarve si pretendon prokuroria në ankesë, andaj, përfundimin e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo Gjykatë si të drejtë dhe ligjor ndërsa pretendimet e prokurorisë si në ankesë i refuzoi si të pabazuara pasi që si të tilla ishin të përgjithësuar dhe me theks për kalimin e barrës së provës për pafajësinë në të akuzuarit, prandaj nga arsyet si më lartë kolegji i kësaj gjykate gjen se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.151/2024, datë 23.05.2024

Bashkëpunëtore Profesionale,

Gresë Latifi

Kryetare e kolegjit,

Kadrije Goga-Lubishtani

Vaton Durguti

Afërdita Bytyçi